

LIGJI NR. 02/L-88

PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Kuvendi i Kosovës

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe rregullatives ligjore përkitazi me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës ,

Miraton:

LIGJIN PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1. Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të krijuara gjatë shekujve, gjithashtu mjetet legale dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektimi mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të këtyre thesareve në pajtim me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës.

1.2. Ky ligj vendos marrëdhëniet midis pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, qofshin ata individë ose komunitete ose autoritete publike - përgjegjës për vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Kjo gjithashtu do të krijojë përgjegjësitë e personave privatë dhe institucioneve publike në lidhje me trashëgiminë kulturore.

1.3. Trashëgimi kulturore në kuadër të këtij ligji përfshinë: trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit e punës. Shtrirja e ligjit duhet të jetë e përkufizuar për çështjet që ndërlidhen në mënyrë specifike me trashëgiminë kulturore. Edhe trashëgimia kulturore që ndërlidhet ose derivon nga konfesionet fetare do të jetë e qeverisur nga legjislacioni i cili rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë.

1.4. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë legalisht fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

Neni 2

Definimi i nocioneve në kontekstin e ligjit

2.1 “**Trashëgimi kulturore**” përfshin trashëgiminë arkitekturale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore.

2.2 “**Trashëgimi arkitekturale**” përbëhet nga:

- a). Monumentet: Konstruktivet dhe strukturat e dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike shkencore me interes shoqëror ose teknike duke përfshirë elementet e luajtshme si pjesë të saj.

- b). Ansamblet ose tërësia e ndërtesave: Grupet e ndërtesave urbane ose rurale të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror ose teknik, në ndërveprim me njësitë e caktuara topografike.
- c). Fushat e konservimit arkitekturale: Fushat që përmbajnë punë të kombinuara të dorës së njeriut dhe natyrës, të dalluara nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, të interesit shoqëror dhe teknik.

2.3 “**Trashëgimi arkeologjike**” nënkupton ndërtimet, strukturat dhe grupet e ndërtesave, vendbanimeve të zhvilluara, objektet e luajtshme, monumentet e llojeve të ndryshme dhe përbërjeve të tyre, të gjetura në tokë ose nën ujë. Trashëgimi arkeologjike mund të jetë e mbrojtur përmes një rezervati arkeologjik, ku të mbeturat qoftë të dukshme ose të fshehta (të padukshme) në terren duhet të mbeten të paprekura.

2.4 “**Pejsazhet kulturore**” nënkupton një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë; një komponentë esenciale e ambientit të njerëzve, një shprehje e diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të tyre kulturore e natyrore, dhe një krijues i identitetit të tyre.

2.5 “**Trashëgimi e luajtshme**” janë objektet që janë shprehje ose evidencë e kreativitetit njerëzor ose e një zhvillimi natyror, të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, të rëndësishme dhe të interesit shkencor ose shpirtëror.

2.6 “**Trashëgimi shpirtëror**” përfshin format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

2.7 “**Inventarizim**” është një veprimtari hulumtuese për regjistrimin paraprak dhe dokumentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

2.8 “**Dokumentim**” është paraqitja e vlerave tipologjike dhe faktike, si dhe faktorëve me interes sipas neneve 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 të këtij ligji përmes mjeteve grafike dhe fotografike, dhe të dhënave të shkruara.

2.9 “**Mbrojtja**” është një nomenklaturë e masave të mbrojtjes të natyrës juridike me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore.

2.10 “**Konservim**” nënkupton krijimin e kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen.

2.11 “**Restaurim**” nënkupton një veprimtari me qëllim të ruajtjes dhe ekspozimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.

2.12 “**Administrimi**” nënkupton mbikëqyrjen dhe menaxhimin e përdorimit të trashëgimisë kulturore.

2.13 “**Përhapja**” nënkupton një veprimtari arsimore dhe rritëse të vetëdijesimit në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore.

2.14 “**Dëmtimi**” nënkupton cilindo dëmtim ndaj vlerave të trashëgimisë kulturore.

2.15 “**Vlerësimi i trashëgimisë kulturore**” nënkupton procesin e hulumtimit, studimit, dokumentimit dhe përzgjedhjes për procesin e mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, administrimit dhe përhapjes së vlerave të saj.

2.16 “**Lista e trashëgimisë kulturore**” përfshinë gjetjet në inventarin e trashëgimisë kulturore që janë përzgjedhur për ruajtje dhe mbrojtje nga Institucioni kompetent për këtë ligj.

2.17 “**Ministria**” është Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2.18 “**Ministri**” është ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2.19 **“Institucioni kompetent”** nënkupton një Institucion të përcaktuar me ligj për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e ruajtjes, konservimin, restaurimin, administrimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore.

2.20 **“Perimetri i monumentit”** është kufiri i hapësirës së mbrojtur e lidhur me trashëgiminë kulturore të mbrojtur, që përcaktohet në një plan nga Institucioni kompetent.

2.21 **“Zona e mbrojtur”** nënkupton një hapësirë të vendit siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor, i cili është ambienti i perimetrit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme që mund të mbrohet nga ndonjë zhvillim ose veprimtari që mund të dëmtojë kuadrin e dukshëm ose dëmtim tjetër të trashëgimisë kulturore.

2.22 **“Sipërfaqe e mbrojtur”** është një sipërfaqe që mund të përfshijë burime natyrore ose ambientale të mbrojtura, ose trashëgimi kulturore të paluajtshme siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

2.23 **“Zonë e veçantë”** është një hapësirë e përcaktuar me planet hapësinore që kërkon një organizim të veçantë, zhvillim, përdorim ose mbrojtje, siç është përcaktuar në nenin 12.2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

2.24 **“Muzetë”** janë institucione jo-profitabile dhe të hapura për publikun që të hulumtojnë, konservojnë, mbledhin, komunikojnë dhe ekspozojnë trashëgiminë e luajtshme për qëllime të studimit, të edukimit dhe të shijimit në shërbim të shoqërisë dhe të zhvillimit të saj.

Neni 3

II. Inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e përkohshme e trashëgimisë kulturore

3.1. Identifikimi i trashëgimisë kulturore bëhet nga mënyra e inventarizimit dhe implementimit nga ana e Institucionit kompetent, në pajtim me ligjin.

3.2. Inventarizimi dhe dokumentimi përmbajnë grafikën paraprake, paraqitjen pamore dhe përshkrues të të dhënave themelore të trashëgimisë kulturore: emrat e pronarit, poseduesin ose shfrytëzuesin, dhe referencat për lokacionin, paraqitjen pamore, tipin dhe datën në pajtim me një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj.

3.3. Ministria krijon bazën e të dhënave (data-base) për trashëgiminë kulturore të standardizuar dhe të centralizuar në të dy format, të shkruar dhe elektronike. Qasja në këto të dhëna lejohet përmes një rrjeti institucional.

3.4. Zyrtarit profesional nga Institucioni kompetent i jepet e drejta për të verifikuar vlerën dhe gjendjen e trashëgimisë kulturore gjatë procesit të inventarizimit dhe vlerësimit, pas 7 ditësh të njoftimit të pronarit.

3.5. Bazuar në kriteret e caktuara përmes një akti nënligjor dhe në pajtim me nenin 3.2, Institucioni kompetent përzgjedh nga inventarizimi i trashëgimisë kulturore gjetjet dhe objektet për t'u dhënë në mbrojtje të përkohshme në kuadër të Listës së trashëgimisë kulturore.

3.6. Objektet e përfshira në Listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme duhet të jenë nën mbrojtje të përkohshme për një vit. E drejta për kompensim për ndonjë humbje financiare bartet në gjykatë nëse objekti nuk është nën mbrojtje të përhershme pas një viti. Kompensimi i tillë vlerësohet nga një komision i pavarur që themelohet nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore.

3.7. Trashëgimia kulturore nën mbrojtjen e përkohshme, në pajtim me këtë ligj, ka attribute të njëjta me trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme, siç është përcaktuar në nenin 4.

3.8. Dhënia e lejes (lejimi) për ndërtim ose veprimtari tjera që mund të ndikojnë në vlerat ose ndryshojnë tërësinë ose strukturën e objektit të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme bëhet vetëm me miratimin me shkrim të Institucionit kompetent.

Neni 4

Mbrojtja dhe masat legale

- 4.1. Asetet e trashëgimisë kulturore të propozuar nga Institucioni kompetent, personat juridikë ose fizikë për mbrojtje të përhershme grumbullohen në pajtim me kriteret e vendosura nga një akt nënligjor, i bazuar në këtë ligj.
- 4.2. Asetet e trashëgimisë kulturore siç është përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji të propozuar për mbrojtje nga persona juridikë ose fizikë kalojnë një vlerësim nga Institucioni kompetent në pajtim me nenin 4.1 të këtij ligji.
- 4.3. Asetet e trashëgimisë kulturore të propozuar për mbrojtje të përhershme do të paraqiten Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore për rishikim, adaptim ose refuzim.
- 4.4. Vendimi për përfshirjen e objekteve në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme të përcaktuar nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore, nënshkruhet nga ministri me ç'rast hyn në fuqi mbrojtja e përhershme e tyre me këtë ligj. Lista e trashëgimisë kulturore do të jetë e hapur për publikun.
- 4.5. Miratimi i vendimeve për objektet nga ana e ministrit për t'u përfshirë në Listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtjen e përhershme në pajtim me nenin 4.4 bëhet të paktën 15 ditë pas datës së pranimit të tyre në Ministri.
- 4.6. Objektet e trashëgimisë kulturore të përfshira në Listën e trashëgimisë, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, regjistrohen në Agjencionin kadastral dhe gjeodet të Kosovës, në të dy nivelet qendror dhe lokal.
- 4.7. Njoftimi për përfshirjen e një objekti në Listën e trashëgimisë kulturore do të bëhet me anë të shpalljes në Gazetën zyrtare brenda 28 ditësh me njoftim me shkrim për pronarin.

Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore

- 4.8. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore, është organ i cili krijohet nga Kuvendi i Kosovës, i cili përcakton edhe objektin e veprimtarisë së tij në fushën e trashëgimisë kulturore. Ai përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat tri (3) vjeçar nga Kuvendi i Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë. Kuvendi i Kosovës, miraton buxhetin e Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore do të rregullohet me një akt të brendshëm të miratuar prej tij.
- 4.9. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore do të identifikojë masat e domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi Kulturore për secilin vit nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me këtë ligj. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore, në ushtrimin e veprimtarisë së tij bashkëpunon me Institucionet kompetente që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Obligimet e personave juridik dhe fizik për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

- 4.10. Secili person juridik dhe fizik ka për detyrë që të kujdeset për mbrojtjen e tërësisë së trashëgimisë kulturore nëse ai/ajo është pronar, posedues ose shfrytëzues i kësaj trashëgimie kulturore.

4.11. Cilido person fizik apo juridik që dëmton trashëgiminë kulturore, pavarësisht nga marrëdhëniet e tyre pronësore me të, dënohet ose sanksionohet në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligjit për kundërvajtje dhe në pajtim me nenin 11 të këtij ligji.

Inspektorët e trashëgimisë kulturore

4.12. Inspektorët e caktuar nga Ministria, në pajtim me një akt nënligjor bazuar në këtë ligj, vlerësojnë kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe ndërmarrin masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

4.13. Pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i trashëgimisë kulturore të mbrojtur është i obliguar të mos pengojë inspektimin që kryhet sipas nenit 4.12.

Konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore

4.14. Cilado ndërhyrje që ndikon në tërësinë ose vlerat e trashëgimisë kulturore kërkon leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

4.15. Institucioni kompetent urdhëron ndaljen e menjëhershme për një periudhë të pacaktuar kohore të çdo lloj pune të paautorizuar në trashëgiminë kulturore.

4.16. Veprimet konservuese dhe restauruese në lidhje me trashëgiminë kulturore bëhen nga Institucioni kompetent dhe personat juridikë dhe fizikë, të licencuar nga Ministria, në pajtim me një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj. Puna e bërë me licencë mbikëqyret nga Institucioni kompetent.

4.17. Projektet konservuese dhe restauruese të trashëgimisë kulturore zbatohen vetëm pas aprovimit të shkruar për to nga Institucioni kompetent.

4.18. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese bëhen në pajtim me aktin nënligjor në pajtueshmëri me nenin 4.17 të këtij ligji.

4.19. Procesi i ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese bëhet nën mbikëqyrjen e Institucionit kompetent.

4.20. Institucioni kompetent ndalon punën konservuese dhe restauruese nëse identifikon parregullsi gjatë zbatimit të tyre dhe derisa kushtet e nevojshme të plotësohen për përmbyllje të punëve të tilla.

Shitja dhe kalimi apo vendosja e të drejtave pronësore nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent i trashëgimisë kulturore

4.21. Trashëgimia kulturore mund të shitet, trashëgohet ose dhurohet vetëm brenda territorit të Kosovës dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi me të cilin drejtohen çështjet pronësore. Ministria ka përparësi për të blerë trashëgiminë kulturore sipas çmimit të tregut, që do të vlerësohet nga një komision i pavarur që krijohet nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore.

4.22. Të drejtat pronësore Trashëgimia kulturore e mbrojtur mund të kalojë dhe vendoset në të drejta pronësore nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent në pajtim me legjislacionin relevant ku ka rrezik të identifikuar të dëmtimit të qëllimshëm ose shkatërrimit të trashëgimisë kulturore ose ku është ndërmarrë veprim i pamjaftueshëm nga pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi për të mbrojtur kushtet dhe gjendjen e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Kompensimi i paguhet pronarit në bazë të vlerës në treg të pronës dhe reflektimit të kushteve të pronës. Niveli i kompensimit përcaktohet nga një komision i pavarur i themeluar nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore.

4.23. Trashëgimia kulturore e mbrojtur që është në pronësi private dhe që përfiton nga fondet publike për punë rreth konservimit dhe restaurimit, sipas nenit 5 të këtij ligji është subjekt i kërkesës

për qasje publike për një periudhë kohore afat i arsyeshëm e cila do të përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 5

Financimi dhe masat fiskale për trashëgiminë kulturore

5.1. Fondet për hulumtimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, prezantimin dhe përhapjen e trashëgimisë kulturore sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe përmes burimeve financiare të autoriteteve lokale dhe ndonjë burimi tjetër vendor dhe ndërkombëtar qoftë ai donacion ose sponsorim.

5.2. Buxheti i Konsoliduar i Kosovës mbi trashëgiminë kulturore përdoret për mbulimin e veprimeve në lidhje me trashëgiminë kulturore në pajtueshmëri me nenin 4 të këtij Ligji. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore vlerëson projektet e propozuara të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse, ndërsa Ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e këtyre projekteve në baza proporcionale nga buxheti i saj.

5.3. Trashëgimia kulturore nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme lirohet nga tatimi mbi pronën, në pajtim me këtë ligj.

5.4. Çdo investim me qëllim konservimi dhe restaurimi në trashëgiminë kulturore të mbrojtur, nga personat juridikë ose fizikë, shumat e të cilave janë të konfirmuara dhe aprovuara nga Institucioni kompetent, lirohet nga detyrimi për tatimin në të hyra deri në vlerën e shumës së investuar nëse kjo nuk është rregulluar ndryshe me ndonjë legjislacion tjetër në fuqi.

5.5. Trashëgimia kulturore në pronësi private që është e lejuar për publikun, sipas nenit 4.23 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi trashëgimi.

Neni 6

III. Trashëgimi arkitektuale

6.1. Trashëgimi arkitektuale është pjesë e trashëgimisë të paluajtshme. Ajo përbëhet nga monumentet, ansamblet (tërësitë) dhe hapësirat arkitektuale konservuese. Trashëgimi arkitektural daton prej para-historisë deri në kohën e tashme.

6.2. Inventarizimi, dokumentimi dhe mbrojtja e trashëgimisë arkitektuale rregullohet sipas nenit 3 dhe 4 të këtij Ligji. Vlerësimi profesional dhe shkencor për vlerat e saj shënohet në Listën e trashëgimisë kulturore.

6.3. Monumentet arkitektuale ruhen në të gjitha elementet e tyre përbërëse, tiparet arkitektuale dhe teknike. Hapësira e mbrojtjes së monumentit përfshin secilin ndërtim ose strukturë të vlerës së pranuar brenda perimetrit të monumentit, dhe përcaktohet në një plan të Institucionit kompetent.

6.4. Monumentet arkitektuale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

6.5. Ansamblet (tërësitë) dhe hapësirat e konservuara arkitektuale nën mbrojtje mund të jenë në ambiente rurale ose urbane. Ndërtesat e përfshira në ansamble dhe hapësira të tilla janë të mbrojtura nga jashtë, dhe përcaktohen si sipërfaqe të mbrojtura në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor, dhe mund të klasifikohet si zonë e veçantë në pajtueshmëri me nenin 12 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

6.6. Politikat për ruajtjen, menaxhimin dhe shtimin e fushave të konservuara arkitektuale përcaktohen së bashku nga Institucioni kompetent dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor.

6.7. Çdo punë për modifikim ose demolim të një monumenti arkitektural ose ndonjë veprim konservues ose restaurues që mund të ndikojë në vlerat atribuese të monumentit, kërkon pëlqimin me shkrim të Institucionit kompetent.

6.8. Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në asamble ose zona konservuese arkitekturale kërkon pëlqim me shkrim nga Institucioni kompetent.

6.9. Aplikimi për leje për ndërtimin e ndërtesave ose krijimtari tjetër brenda zonës së mbrojtur të një monumenti arkitektural, ose brenda një hapësire konservuese arkitekturale, ose që ndikon në mjedisin e një asambleje, paraqitet për shqyrtim në Institucionin kompetent. Institucioni kompetent ka veto mbi dhënien e një lejeje të tillë. Nëse Institucioni kompetent nuk përgjigjet brenda 15 ditëve në lidhje me aplikimin për ndërtimin e ndërtesave ose zhvillimeve tjera, leja mund të përcaktohet nga autoriteti relevant për planifikim dhe ndërtim.

6.10. Trashëgimi arkitektural nën mbrojtje shenjzohet qartë me një shenjë të dukshme. Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e asambleve ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale bëhet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

6.11. Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjesëshme ose komplete e ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

6.12. Monumentet arkitekturale ose ndërtesat brenda asambleve që janë në një gjendje të keqe të riparimit ose janë në rrezik të dëmtimit domethënës bëhen objekt i një procedure riparuese urgjente ose emergjente. Institucioni kompetent i dërgon pronarit një njoftim të shkruar në afat shtatë ditësh me qëllim të hyrjes në objekt për të ndërmarrë një punë të tillë. Aty ku gjendja e pronës ka rënë për shkak të dështimit të pronarit që të kryejë detyrën e tij/saj për t'u kujdesur sipas nenit 4.10, atëherë kosto e punëve të tilla kompensohet nga pronari. Kjo procedurë lë vend për ankesë në rastet e kushteve të varfërisë financiare.

6.13. Të drejtat pronësore Një monument arkitektural mund të kalojnë dhe të vendosën nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent në rastet ku ka pasur dështim të konservimit të monumentit sipas dispozitave të nenit 4.10, pas dhënies së një njoftimi të shkruar që përmban orarin e specifikuar të punëve brenda 90 ditësh. Kompensimi vlerësohet sipas nenit 4.22 të këtij ligji.

6.14. Përdorimi me qëllim përfitimi ekonomik dhe kulturor i trashëgimisë arkitekturale autorizohet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent, në rastet ku vlerat e trashëgimisë arkitekturale janë të mbrojtura.

Neni 7

IV. Trashëgimi arkeologjike

Tipet e trashëgimisë kulturore janë:

7.1. "Trashëgimi arkeologjike" përbëhet nga objektet e paluajtshme dhe të luajtshme siç janë përcaktuar në nenin 2.3 të këtij ligji.

7.2. "Objektet arkeologjike të paluajtshme" janë monumentet, vendbanimet, strukturat e ndërtuara nga dora e njeriut dhe kompozicion stratigrafike.

7.3. "Objektet arkeologjike të luajtshme" janë gjetjet gjatë gërmimeve arkeologjike, të gjetura rastësisht, të cilat janë pasqyrim ose evidencë e kreativitetit njerëzor.

Masat paraprake dhe shpëtuese

7.4. Kur një aplikim për leje për të ndërtuar një ndërtesë ose krijimtari tjetër në trashëgiminë e ditur arkeologjike pranohet në autoritetin lokal të planifikimit dhe ndërtimit, ai aplikim parashtrohet menjëherë për shqyrtim në Institucionin kompetent. Aplikuesi nuk mund të marrë lejen për të filluar punën, para se të bëhet një marrëveshje me Institucionin kompetent për të ndërmarrë një studim vlerësues të trashëgimisë arkeologjike. Sasia e koston që paraqitet nga aplikuesi për këtë qëllim përcaktohet nga një formulë e dhënë në aktin nënligjor të bazuar në këtë ligj.

7.5. Institucioni kompetent njofton autoritetin lokal për planifikim dhe ndërtim nëse aplikuesit mund t'i jepet leja në lidhje me nenin 7.4, brenda periudhës 20 ditëshe, dhe mund ta bëjë këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë se ku krijimtaria duhet të vendoset. Nëse Institucioni kompetent nuk bën një njoftim të tillë brenda 20 ditësh, leja është e vetëkuptuar.

7.6. Gjatë punëve ndërtuese, nëse bëhet ndonjë zbulim arkeologjik zbuluesi ose investitori duhet të informojë Institucionin kompetent menjëherë, por jo më vonë se sa në ditën pasuese nga koha e zbulimit. Institucioni kompetent ka të drejtë që menjëherë të ndalë punët ndërtimore të filluara dhe të ndërmarrë një studim vlerësues dhe shpëtues arkeologjik në vend për një kohë të kufizuar që duhet të përcaktohet nga një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj. Punët krijuese (ndërtuese) mund të rifillojnë vetëm pas lejes me shkrim nga Institucioni kompetent.

7.7. Të gjeturat arkeologjike të bëra të ditura dhe me interes për arkeologjinë e Kosovës shpërblehen financiarisht, pas aprovimit nga Institucioni kompetent. Niveli i shpërblimit do të përcaktohet nga një komision i pavarur i themeluar nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore.

7.8. Zbulimet e rastësishme arkeologjike njoftohen brenda tri ditësh në Institucionin kompetent.

7.9. Të gjitha të gjeturat arkeologjike dhe ato të zhgroposura nga gërmimet arkeologjike janë pronë e Kosovës.

7.10. Autoriteteve përgjegjëse për ndonjë punë publike u kërkohet që t'i binden dispozitës së nenit 7.4 dhe 7.9 plotësisht.

Rezervatet arkeologjike

7.11. Rezervatet arkeologjike janë hapësirat e një rëndësie të veçantë për arkeologjinë të cilat ruhen për gjeneratat e ardhshme dhe përcaktohen në një plan nga Institucioni kompetent. Rezervatet e tilla klasifikohen si zona të veçanta në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

7.12. Bazuar në informatat që përmban lista e inventarit, Institucioni kompetent përcakton rezervatet arkeologjike dhe i vendos ato nën hapësira të tilla nën mbrojtje të përkohshme në pajtim me nenin 3 të këtij ligji me qëllim që të përfshihet në procedurën për mbrojtje të përhershme.

7.13. Shpëtimi arkeologjik do të bëhet vetëm në rezervatet arkeologjike nga Institucioni kompetent. Veprimtari të tilla mund të ndodhin vetëm në rrethana përjashtuese të lidhura me fatkeqësi natyrore ose kërcënime tjera të larta.

7.14. Nuk lejohet asnjë veprimtari që shkakton dëmtim të ndonjë rezervati arkeologjik pa lejen e shkruar nga Institucioni kompetent.

Zonat dhe hapësirat e mbrojtura

7.15. Zonat e mbrojtjes përcaktohen rreth vendeve të ditura të trashëgimisë arkeologjike.

7.16. Rradiusi (kufiri) i zonës së mbrojtur është 100 metra nga perimetri i vendit të trashëgimisë së mbrojtur arkeologjike. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose të ngushtohet dhe kjo përcaktohet në një plan të Institucionit kompetent dhe në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor.

7.17. Çdo aplikim për leje që të ndërtohen ndërtesa ose bëhet krijimtari tjetër brenda Zonës së mbrojtur të një vendi të trashëgimisë arkeologjike paraqitet për shqyrtim në Institucionin kompetent. Institucioni kompetent ka veton mbi dhënien e një leje të tillë. Nëse Institucioni kompetent nuk përgjigjet brenda 20 ditësh, leja mund të përcaktohet nga autoriteti relevant i planifikimit dhe ndërtimit.

7.18. Lejohet ndërhyrja në tokë brenda zonës së mbrojtur në kuptimin e veprimtarive bujqësore me leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

7.19. Sipërfaqet e rëndësisë potenciale të trashëgimisë arkeologjike përcaktohen gjatë procesit të inventarizimit, në pajtim me nenin 3 të këtij ligji dhe përcaktohen si sipërfaqe të mbrojtura në pajtim me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor. Aplikimi për ndërtim apo krijimtari tjetër në hapësira të tilla përcaktohet në pajtim me dispozitat e nenit 7.4 të këtij ligji.

Procedurat për gërmim arkeologjik

7.20. Gërmimet arkeologjike mund të bëhen vetëm me lejen e shkruar të Institucionit kompetent. Vendimi lidhur me këtë leje jepet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës.

7.21. Institucionet ose personat fizikë apo juridikë mund të lejohen të bëjnë gërmime arkeologjike vetëm me licencë sipas kriterëve të standardeve profesionale dhe mbikëqyrjes që përcaktohet në aktin nënligjor të bazuar në këtë ligj.

7.22. I licencuari për gërmim arkeologjik paraqet një raport të gërmimit para Institucionit kompetent, përfshirë materialet fotografike, skicat, vizatimet, planet, materialet topografike, materialet kartografike dhe materiale tjera shkencore e profesionale të përdorura gjatë gërmimit, si dhe ndonjë zbulim arkeologjik, brenda një viti të fillimit të gërmimit arkeologjik.

7.23. Kriteret mbi dokumentimin dhe regjistrimin e hulumtimeve arkeologjike dhe zbulimeve të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike specifikohen nga një akt nënligjor nga ky ligj.

7.24. E drejta e publikimit të hulumtimit arkeologjik i takon poseduesit të licencës për gërmimin arkeologjik për katër vjet. Pas kësaj kohe, e drejta për publikim është e hapur për arkeologët tjerë të licencuar.

Të drejtat dhe obligimet

7.25. Trashëgimi arkeologjike e gjetur ose ekzistuese brenda hapësirës së Kosovës është pronë e Kosovës.

7.26. Kompensimi bëhet për humbjen e tokës punuese bujqësore ose pronës tjetër ku janë bërë zbulimet dhe ato ruhen në vend (in situ). Kompensimi vlerësohet nga një komision i pavarur, i themeluar nga Institucioni kompetent në pajtueshmëri me këtë ligj.

7.27. Pronari ose shfrytëzuesi i tokës me rëndësi potenciale arkeologjike gjatë punës ose përdorimit nuk lejohet të dëmtojë tërësinë e trashëgimisë arkeologjike nën tokë ose nën ujë. Pronari ose shfrytëzuesi i tokës me rëndësi potenciale arkeologjike ka kufizime në përdorim dhe të drejta.

Shpronësimi dhe kompensimi

7.28. Ish-pronari ose shfrytëzuesi i tokës në të cilën është gjetur trashëgimi arkeologjike dhe që është shpronësuar sipas nenit 4.22 ka të drejtën për kompensim të arsyeshëm në para ose shkëmbim të tokës. Kompensimi ose shkëmbimi i drejtë i tokës përcaktohet nga një komision i pavarur i themeluar nga Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore.

Këshillat dhe udhëzimet profesionale

7.29. Institucioni kompetent për trashëgimi arkeologjike është i obliguar që të sigurojë këshillime administrative dhe procedurale mbi çështjet lidhur me trashëgiminë arkeologjike.

7.30. Ministria siguron fonde vjetore për shpëtim arkeologjik.

Qasja publike

7.31. Trashëgimi arkeologjike mund të jetë subjekt i kërkesave të qasjes publike në pajtim me nenin 4.23 të këtij ligji.

7.32. Të gjeturat e bëra nga hulumtimet arkeologjike prezantohen dhe sigurohen për publikun përmes ekspozitave dhe publikimeve.

Neni 8

V. Peizazhi kulturor

Peizazhi kulturor përcaktohet si zonë e veçantë në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor.

Neni 9

VI. Trashëgimi e luajtshme

9.1. Trashëgimi e luajtshme sikurse është përcaktuar në nenin 2.5 përbëhet nga:

- objektet ose pjesët e objekteve të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike ose zbulime të rastësishme,
- dorëshkrimet, dokumentet fetare ose civile, librat, publikimet me rëndësi historike, shkencore ose artistike,
- objektet etnografike,
- objektet, pjesët integrale të koleksioneve të përhershme të muzeve dhe galerive,
- objektet e lidhura me kulte fetare,
- objektet e lidhura me ngjarje të rëndësishme historike dhe jetës së personaliteteve historike,
- veprat artistike të të gjitha llojeve dhe zhanreve siç janë vizatimet, pikturat, skulpturat etj.
- botimet origjinale, posterët dhe fotografitë,
- punët e artit të aplikuar të bëra nga materialet si xhami, qeramika, metali, druri, pëlhura dhe letra etj.
- punët antologjike të artit të aplikuar të dizajnit dhe objekteve moderne në prodhimet rendore të rëndësisë së veçantë artistike ose historike,
- orendi të vjetra,
- tapiceri, veshje dhe instrumente muzikore,
- objektet e karakterit historik në lidhje me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë,
- objektet tjera të rëndësisë historike, artistike, shkencore ose kulturore,
- objektet numizmatike, medalionët dhe koleksionet filatelike,
- dokumentet e arkivit, përfshirë këtu edhe regjistrimet e filmit, fotos dhe video-materialet.

9.2. Inventarizimi, dokumenti dhe mbrojtja e trashëgimisë së luajtshme rregullohet sipas nenin 3 dhe 4 të ligjit aktual.

9.3. Procedurat për vlerësimin e trashëgimisë së luajtshme implementohen nga Institucioni kompetent sipas aktit nënligjor të bazuar në këtë ligj.

Koleksionet publike

9.4. Koleksionet publike të trashëgimisë së luajtshme janë objektet nën pronësi të institucioneve publike të Kosovës. Koleksionet publike janë nën mbrojtje në pajtim me këtë ligj.

9.5. Sipas këtij ligji, objektet e luajtshme, pjesët përbërëse të trashëgimisë kulturore, komplekset historike, ndërtesat fetare janë nën mbrojtje dhe ato nuk mund të lëvizin nga konteksti natyror i vendit, ku janë të vendosura, pa lejen e shkruar nga Institucioni kompetent.

9.6. Trashëgimia e luajtshme e përcaktuar sipas nenit 9.1 që është më e vjetër se 100 vjet vendoset automatikisht nën mbrojtje.

9.7. Edhe trashëgimia e luajtshme që daton para vitit 1453 është pronë publike e Kosovës.

9.8. Të gjitha objektet ose pjesët e objekteve të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike ose zbulimeve të rastësishme janë pronë e Kosovës sipas nenit 7.10.

9.9. Muzetë, siç janë përcaktuar në nenin 2.24, janë Institucione kompetente për menaxhimin e koleksioneve publike të trashëgimisë së luajtshme.

9.10. Veprimtarit bazike të muzeve publike, bazuar në këtë ligj, rregullohen me Ligjin për Institucionet e kulturës.

9.11. Dhurimi i trashëgimisë së luajtshme nga personat fizikë apo juridikë për të shtuar koleksionet publike ka lehtësim të taksës mbi dhurata të tilla. Niveli i lehtësimit të taksës rregullohet nga legjislacioni përkatës fiskal.

Masat konservuese të mbrojtjes dhe ruajtja e trashëgimisë së luajtshme kulturore

9.12. Institucioni kompetent ndërmerr masat për konservimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje në pajtim me aktin nënligjor të bazuar në këtë ligj, i cili do të përcaktojë kriteret dhe pajisjet e domosdoshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e tij, dhe masat e domosdoshme preventive dhe siguroese sa i përket dëmtimit, dekompozimit, shkatërrimit ose humbjes.

9.13. Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë së luajtshme bëhet në laboratore nga personat e licencuar në pajtim me nenin 4.16.

9.14. Koleksioneve publike të trashëgimisë së luajtshme që janë në ekspozim publik u sigurohet hapësira nga Ministria për prezantimin, arkivimin, ruajtjen dhe mbrojtjen adekuate të tyre.

9.15. Ministria është përgjegjëse për krijimin e kushteve optimale për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë së luajtshme që mbahen në institucione publike me qëllim që të mbrohen nga vjedhja, plaçkitja, tjetërsimi ilegal dhe ndonjë akt tjetër ilegal, përfshirë këtu përvetësimin, dëmtimin dhe shkatërrimin.

9.16. Koleksionet publike të trashëgimisë së luajtshme janë të hapura për publik përmes ekspozitave të përhershme ose të përkohshme, publikimeve dhe mekanizmave tjerë të përshtatshëm.

Koleksionet private

9.17. Koleksionet private të objekteve të trashëgimisë së luajtshme regjistrohen në Listën e trashëgimisë kulturore në pajtim me nenin 4 të këtij ligji.

9.18. Pronari privat i një objekt të përcaktuar si trashëgimi e luajtshme është i detyruar për përkujdesje të mbrojtjes së tërësisë së një objekti të tillë në pajtim me nenin 4.10 të këtij ligji. Çfarëdo dëmtimi, shkatërrimi, humbje ose vjedhje e një objekti të tillë raportohet në Institucionin kompetent brenda tri ditësh.

9.19. Nëse pronari i një objekti të trashëgimisë së luajtshme dështon të kryejë detyrën e tij/saj për t'u përkujdesur sipas nenit 4.10 të këtij ligji, Institucioni kompetent i dërgon një njoftim të shkruar me afat shtatë ditësh me qëllim të ndërmarrjes së masave të domosdoshme siguroese dhe mbrojtëse. Shuma e kostos për një punë të tillë kompensohet nga pronari. Kjo procedurë ka mundësinë e ankesës në rastet e varfërisë financiare.

9.20. Të drejtat pronësore Objekti i trashëgimisë së luajtshme mund të kalojnë dhe të vendosen nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent nëse është i kërcënuar nga dëmtimi apo shkatërrimi ose nëse pronari ka dështuar të ndërmerr masat e domosdoshme për sigurimin dhe ruajtjen e tij në pajtim me nenin 4.22.

Kufizimet legale mbi ekspozimin

9.21. Siguria e objekteve të trashëgimisë së luajtshme nën pronësi private gjatë ekspozimit garantohej nga organizatori i ekspozitës sa i përket sigurimit, dëmtimit, shkatërrimit, vjedhjes ose humbjes sipas kriterëve që përcaktohen nga një akt nënligjor i bazuar në këtë ligj. Kompensimi vlerësohet sipas nenin 4.22 të këtij ligji.

9.22. Pronari privat i objekteve të trashëgimisë së luajtshme ka përparësi në të drejtën për të kërkuar vlerësim profesional të vlerave të tyre.

Qarkullimi i trashëgimisë së luajtshme

9.23. Objekti i trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje mund të qarkullojë përkohësisht jashtë Kosovës në rrethana të kufizuara për qëllime të konservimit, restaurimit dhe ekspozimit, me leje të shkruar nga Ministri në pajtim me aktin nënligjor të bazuar në këtë ligj, akt ky që vendos kriteret për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së një objekti të tillë.

9.24. Blerësi i një objekti të trashëgimisë së luajtshme që është blerë në besim, por është vënë në shitje me mashtrim, kompensohet për humbjen e objektit pas kthimit të tij tek pronari i vërtetë. Blerësit dhe dilerët të cilët me dije shesin ose tregtojnë me objekte të vjedhura të trashëgimisë së luajtshme i nënshtrohen masave penale në pajtim me të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

9.25. Objekti i trashëgimisë së luajtshme i konfiskuar nga autoritetet legale kompetente, pronari i së cilës nuk mund të identifikohet, paraqitet në Institucionin kompetent.

9.26. Personat fizikë dhe juridikë që merren me shitjen e objekteve të trashëgimisë së luajtshme duhet të jenë të licencuar nga Ministria në pajtim me një akt nënligjor të bazuar në këtë ligj, që lidhet me regjistrimin të objekteve që i kanë ata dhe shitjes së pandershme të tyre.

Tjetërsimi

9.27. Objektet e trashëgimisë së luajtshme me pronësi publike nuk mund të tjetërsohen, shiten ose dhurohen.

9.28. Shkëmbimi i objekteve në koleksionet publike mund të bëhet vetëm brenda muzeve publike në Kosovë dhe me miratimin e ministrit.

Importi dhe eksporti

9.29. Nëse është përcaktuar se një objekt i trashëgimisë së luajtshme është në një vend tjetër dhe anasjelltas, atëherë importi, eksporti ose kthimi i tij bëhet në pajtim me një marrëveshje bilaterale.

9.30. Qeveria e Kosovës kërkon, pa kufizim kohor, kthimin e objekteve të trashëgimisë së luajtshme që është marrë jashtë Kosovës pa miratim zyrtar.

9.31. Objektet e trashëgimisë së luajtshme të Kosovës nuk mund të eksportohen pa lejen e shkruar të ministrit.

Neni 10

VII. Trashëgimi kulturore shpirtërore

10.1. Trashëgimi kulturore shpirtërore përfshin format e shprehjes kulturore të traditave popullore, zakonet, gjuhën, festat, ritet, vallet, muzikën, këngët dhe zejet artistike.

10.2. Trashëgimi kulturore shpirtërore është një pjesë integrale e trashëgimisë kulturore të civilizimit në përgjithësi. Kjo është një ndërveprim shpirtëror, korrespondencë e duhur dhe e pakalueshme dhe komunikim.

10.3. Trashëgimi kulturore shpirtërore në forma të ndryshme të dokumentimit dhe të regjistrimeve mbrohet, ruhet dhe promovohet në pajtim me këtë ligj dhe parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikatat gjyqësore.

Neni 11 **VIII. Sanksionet**

Mosbindja ndaj dispozitave të këtij ligji në lidhje me autorizimin e veprimtarive do të gjobitet nga gjykata kompetente me minimum prej 1.000 (një mijë) Euro dhe maksimum prej 500.000 (pesë qind mijë) Euro për secilin veprim të paautorizuar.

Neni 12 **IX. Dispozitat përfundimtare**

12.1. Ky Ligj shfuqizon Ligjin mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës së Kosovës (Gazeta zyrtare e KSAK Nr. 19/77).

12.2. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e termit "Institucioni kompetent", sa i përket këtij ligji, nëse nuk është specifikuar ndryshe në ligj.

12.3. Ministria duhet të përcaktohet, bazuar në këtë ligj, që të lëshojë aktet nënligjore mbi hulumtimin, inventarizimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin dhe përhapjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.

12.4. Shkalla në bazë të së cilës ky ligj do të jetë i aplikueshëm për trashëgiminë fetare-kulturore do të jetë subjekt i legjislacionit ose marrëveshjeve të mëvonshme ndërkombëtare sanksionuese.

12.5. Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

UNMIK/REG/2006/52
06.11.2006